

**VENDIM**  
**Nr.657, datë 25.9.2003**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.321, DATË 5.7.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE SIPAS RRETHEVE,**  
**PROCEDURAT E MIRATIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË DHE KUSHTET E**  
**DHËNIES SË KREDISË NË KUADRIN E KREDISË GREKE PËR STREHIM”,**  
**I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8448, datë 25.1.1999 “Për ratifikimin e kredisë greke për programin e strehimit”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 7/1 shtohen pikat 7/2, 7/3, 7/4 dhe 7/5, me këtë përmbajtje:

“7/2. Deri në livrimin e kredisë greke për programin e strehimit, rastet më emergjente të evidentuara sipas pikës 1/b të vendimit, të trajtohen me fondet e Buxhetit të Shtetit, të cilat i jepen Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në zërin “Investime për ndërtim dhe blerje banesash për familjet, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”. Këto fonde të menaxhohen nga Enti Kombëtar i Banesave, me kushte të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.191, datë 21.6.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve, që ndërtohen me fonde shtetërore”, i ndryshuar. Të ardhurat, që Enti Kombëtar i Banesave mbledh nga shitja e banesave, të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

7/3. Trajtohen me përparësi familjet e evidentuara deri më datë 30.8.1999 sipas pikës 5 të vendimit nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të cilat banojnë në apartamente të marra me qira dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- banojnë në mjedise që nuk janë fond banese ose në banesa me kushte të vështira higjieno-shëndetësore;

- kanë të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar qiranë e banesës;
- kanë në përbërje të tyre një të sëmurë me raport të përhershëm mjekësor;
- janë njëprindërorë dhe kanë në ngarkim fëmijë.

Për të verifikuar rastet më emergjente të përdoren treguesit e mëposhtëm:

- sipërfaqja faktike e shfrytëzimit për frymë të mos jetë më shumë se 6 m<sup>2</sup> për person;
- pagesa mujore për qiranë të mos jetë më pak se 30 për qind e të ardhurave mujore;
- certifikata e gjendjes familjare, në rastet e shkurorëzimit, duhet të jetë e datuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Këto të dhëna t’i dërgohen Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, sipas tabelës që i bashkëlidhet, për efekt llogaritjeje dhe planifikimi. Verifikimi të kryhet brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7/4. Dokumentacioni, që duhet të dorëzojë familja pranë organeve të qeverisjes vendore për të përfituar kredi, është si më poshtë vijon:

- vërtetimi i tre muajve të fundit nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme që, në emër të kryefamiljarit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, nuk rezulton të jenë regjistruar prona të paluajtshme në pronësi ose të lëna në barrë hipotekore;

- vërtetimi i tre muajve të fundit nga zyra e taksave që kryefamiljari ose pjesëtarë të familjes nuk janë subjekt i TVSH-së;

- vërtetim nga Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave që, në emër të kryefamiljarit ose pjesëtarëve të tjerë të familjes, nuk u është kthyer ose kompensuar prona.

7/5. Për familjet e evidentuara, sipas pikës 1/b dhe që përfitojnë kredi, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, përveç verifikimit të dokumentacionit, të kryejnë dhe verifikimin në banesën ku familja jeton me qira.”.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**